REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 14.10.2022. Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës janë 13 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje nga ana e Këshillit.

Fillojmë pa humbur kohë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, do relatohet nga zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë, sot kemi paraqitur relacionin dhe projektvendimin "Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}".

Më datë 12.04.2022, gjyqtarja znj. {...} (që është aktualisht e komanduar në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor) ka paraqitur pranë Këshillit formularin e kandidimit për pjesëmarrjen në skemën e delegimit, nëpërmjet të cilit ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, të përcjellë nga Departamenti i

Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është konstatuar se:

Gjyqtarja {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 08.07.2008 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012.

Me dekret nr. {...}, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës ajo caktohet për kryerjen e stazhit profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Me dekret nr. {...}, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Me Vendim nr. 206, datë 11.10.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me Vendim nr. 457, datë 07.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet komandimi në pozicionin e Këshilltares Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, funksion të cilin e ushtron edhe aktualisht.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 10 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 rezulton se kjo dispozitë rregullon institutin e skemës së delegimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistrati për t'u pranuar në këtë skemë, si dhe detyrimin e Këshillit për të miratuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjen e magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit.

Në zbatim të nenit 45 të Ligjit 96/2016 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar Vendimin nr. 22, datë 07.02.2019, Rregulloren "Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit".

Janë dispozitat përkatëse dhe do t'i gjeni të pasqyruara në relacionin përkatës. Nuk po i lexoj të gjitha dispozitat e rregullores së përmendur më lart.

Lidhur me ngarkesën dhe çështjet në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, informacioni i marrë në rrugë elektronike, pasqyrohet në një tabelë të mëposhtme.

Të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, lidhur me ngarkesën e gjyqtarëve, janë të përditësuara deri më datë 30.09.2022, dërguar në rrugë elektronike nga gjykata respektive (Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat). Në total bëhet fjalë për

pasqyrimin e ngarkesës së 8 gjyqtarëve. Janë të gjitha të dhënat përkatëse dhe ngarkesat e secilit gjyqtar.

Bazuar në rrethanat e faktit të parashtruara sa më sipër, në lidhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të Ligjit nr. 96/2016, si dhe në lidhje me parashikimet e Vendimit nr. 22, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtares {...} në skemën e delegimit, pra të caktimit të saj në këtë skemë pasi:

- gjyqtarja ka dhënë pëlqimin për t'u caktuar në skemën e delegimit, e cila është bashkëlidhur edhe akteve përkatëse që unë po relatoj ditën e sotme;

- ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion;

- nuk ndodhet nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit;

- nuk ushtron funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit të gjykatës;

- është e caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin e saj pasi aktualisht rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat ushtrojnë funksionin 5 (pesë) gjyqtarë (gjyqtare znj. {...} rikthehet në detyrë më 14 dhjetor), ndërsa organika e kësaj gjykate është me 10 (dhjetë) gjyqtarë;

- nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e saj si gjyqtare në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim, për më tepër aktualisht është e komanduar në pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa më sipër, ne konkludojmë/propozojmë se znj. {...} plotëson kriteret për t'u caktuar në skemën e delegimit.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares {...}.

2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 1(një) vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

3. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 22.10.2022 (pra duke filluar nga e nesërmja e përfundimit të komandimit sipas vendimit nr. 457, datë 07.10.2021).

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë diskutime, në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.

2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 1 (një) vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

3. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 22.10.2022.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Sërish fjala për zotin Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Relacioni i radhës bashkëlidhur projektvendimit ka për objekt caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin "Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}". Në supozimin e miratimit të këtij projektvendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit edhe projektvendimin "Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".

Lidhur me këtë të fundit, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është

situata në të cilën ndodhet Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila aktualisht është me një numër të kufizuar gjyqtarësh në detyrë në raport me organikën.

Në detyrë janë vetëm shtatë gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 16 gjyqtarë. Nga sa mund të konstatohet, numri i gjyqtarëve në detyrë të kësaj gjykate është i pamjaftueshëm duke mbajtur në konsideratë edhe numrin e domosdoshëm të gjyqtarëve për përfundimin së gjykuari të një çështjeje, por edhe ngarkesën e çështjeve në këtë gjykatë, ku sipas informacionit periodik më të fundit të dërguar në zbatim të Vendimit të Këshillit nr. 25/2019, për 6-mujorit të parë të vitit 2022, ngarkesa mesatare për gjyqtar në fund të kësaj periudhe ka qenë 23,5 çështje në shqyrtim, numër ky i lartë krahasuar me standardin sasior të punës për gjyqtarët e kësaj gjykate referuar Vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010, të ish-KLD-së, që është pjesë e kuadrit nënligjor në fuqi për vlerësimin e gjyqtarëve sipas Vendimit nr.263, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur relacionit përkatës është integruar edhe tabela përkatëse e cila pasqyron ngarkesën e 7 gjyqtarëve të cilët janë në detyrë:

{...} ka 25 çështje themeli, ndërsa çështje të tjera të gjykuara janë 230.

{...}, çështje të gjykuara 104, çështje themeli 34.

{...}, çështje të gjykuara 135, çështje në gjykim 30.

{...}, 158 çështje të gjykuara, 26 çështje në shqyrtim.

{...}, 117 çështje të gjykuara, 24 në shqyrtim.

{...}, {...}, 13 çështje në shqyrtim.

Në një situatë të tillë, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë të një numri të mjaftueshëm gjyqtarësh, çka do të mundësonte gjykimin normal të çështjeve të regjistruara përpara saj, duke respektuar edhe afatin e arsyeshëm kohor referuar kompleksitetit dhe natyrës së çështjeve që gjykon gjykata e posaçme.

Meqenëse gjyqtarja {...}, në supozimin e miratimit nga Këshilli të projektvendimit për caktimin e saj në skemën e delegimit, do të jetë gjyqtare e kësaj skeme, nisur nga nevojat imediate të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin e saj në këtë gjykatë, për të gjithë periudhën njëvjeçare të delegimit në këtë

skemë.

Lidhur me këtë vlen të theksohet se znj. {...} ka përvojë profesionale mbi 7 vjet gjyqtare, nga të cilat mbi 5 vjet në fushën e së drejtës penale, pra ka një përvojë minimale profesionale që kërkon ligji, referuar nenit 47, pika 2, shkronja "a", të Ligjit nr. 96/2016.

Sipas nenit 45, pika 4, shkronja "a", rezulton se: "4. Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ...: a) në çdo pozicion të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat; ...". Po ashtu, znj. {...} plotëson edhe kushtet shtesë të sigurisë për t'u caktuar pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar sipas shkronjës "b", të kësaj dispozite të posaçme, sipas të cilës Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave referuar shkronjës "b", e cila parashikon se: "b) në një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ..., nëse magjistrati përmbush kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe jep pëlqimin sipas kërkesës së pikës 3, të nenit 47, të këtij ligji". Kështu, znj. {...} dhe familjarët e saj kanë plotësuar dhe dorëzuar rregullisht formularët e vetëdeklarimit për dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", në kuadër të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (për pozicionin e shpallur me Vendimin e Këshillit nr.123, datë 01.04.2021), siç është trajtuar në Vendimin e Këshillit nr. 244, datë 09.06.2021).

Struktura e Projektvendimit

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtarja e skemës e delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për periudhën deri më datë 22.10.2023, pikërisht deri në datën kur përfundon caktimi i saj në skemën e delegimit, pra në varësi të vendimmarrjes së Këshillit në lidhje me projektvendimin që ne e miratuam.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data 22.10.2022, pra nga data e përfshirjes së znj. {...} në skemën e delegimit.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Përcaktimi i këtij rregullimi merr në konsideratë faktin se kjo gjykatë ka buxhetin për të përballuar efektet financiare të vendimit, ndërsa ka pozicione të lira të përhershme, përveç edhe faktin se znj. {...} është kandidate e vetme për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 123, datë 01.04.2021, procedurë në të cilën ajo është kualifikuar, ndërsa vijon vlerësimi i saj etik dhe profesional.

Ndërsa në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së skemës e delegimit znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Së fundi në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi menjëherë i këtij vendimi dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për periudhën deri më datë 22.10.2023.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 22.10.2022.

3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Projektvendimi përkatës të cilit i bashkëngjitet edhe relacioni që unë do ta parashtroj përpara Këshillit, ka për objekt përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja "b", të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë", me bashkë propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me Vendimin nr. 104, datë 05.07.2019, ka vendosur:

"I. Shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për:

a. Dy pozicione "këshilltar ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor; ...

2. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është dy javë nga dita e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. ...".

Brenda afatit për komandimin në pozicionet si më sipër kandidoi edhe znj. {...}, gjyqtare që në atë kohë ka qenë gjyqtare që ushtronte detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Në përfundim të procedurës së komandimit, sipas përcaktimeve të nenit 54 të Ligjit nr.96/2016, i ndryshuar, si dhe atyre të Vendimit të Këshillit nr. 104, datë 05.07.2019, pas vlerësimit të plotësimit të kritereve të komandimit dhe renditjes së kandidatëve, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me Vendimin nr. 206, datë 11.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

"1. Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. 2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 21.10.2019..."

Me vendimin nr. 457, datë 07.10.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: "Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat deri në një vit."

Aktualisht afati i përsëritjes së komandimit të znj. {...} është duke përfunduar, konkretisht më datë 21.10.2022 dhe nuk rezulton të jetë shfaqur vullneti i saj për përsëritje të komandimit, por ajo ka paraqitur një kërkesë për përfshirje në Skemën e Delegimi, siç edhe u trajtua në relacionet e mëparshme.

Propozimi i Komisionit

Për sa më sipër, rezulton të jetë vendi për deklarimin e përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares {...} në fund të afatit të komandimit të përsëritur, sipas Vendimit të Këshillit nr. 457, datë 07.10.2021, pikërisht më datë 21.10.2022, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 57, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili parashikon se: "Afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar"... .

Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur projektvendimin "Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor".

Struktura e Projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimi bën fjalë për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të përsëritjes së afatit të komandimit, më datë 21.10.2022, referuar Vendimit të Këshillit nr. 457, datë 07.10.2021.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në adresën postare elektronike zyrtare.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi menjëherë e tij dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Referuar pikës 4, të nenit 57, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, magjistrati i komanduar gëzon të drejtën që pas periudhës të komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj. Duke iu rikthyer rastit konkret të znj. {...}, meqenëse se kërkesa e saj për përfshirje në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit, u trajtua në projektin pararendës dhe u vendos që gjyqtarja të caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk është vendi që në këtë vendim deklarativ "Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit" të propozohet disponimi për kthimin e saj në pozicionin e

mëparshëm, pra si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim për sa i përket projekt-aktit, të kalojmë në votimin e tij.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 21.10.2022.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Sipas rendit të ditës dhe orës, tashmë kemi shqyrtimin e seancës dëgjimore për kualifikimin/skualifikimin e kandidatit z. {...}, kandidat në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Por në kushtet që informacionet që administrohen në këtë seancë janë informacione sekrete dhe konfidenciale, atëherë kjo

seancë do zhvillohet me dyer të mbyllura.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

(Rikthehet mbledhja në platformën "Online", me çështjen nr. 5, pas trajtimit të çështjes me dyer të mbyllura.)

Naureda Llagami: Ka të bëjë me caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Komisioni edhe në këtë rast ka paraqitur projektvendimin së bashku me relacionin përkatës që ka për objekt caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}.

Më datë 08.09.2022, gjyqtarja znj. {...} (e cila ushtron funksionin e magjistratit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë) ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor formularin e kandidimit për pjesëmarrjen në skemën e delegimit, nëpërmjet të cilit ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, konstatohet se:

Gjyqtarja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë

Universitetit Luarasi në datë 12.07.2010 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekretin nr. {...}, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet për kryerjen e stazhit profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, datë 20.03.2019 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 21.03.2022 ku në këtë pozicion është zgjedhur z. Artan Hajredinaj.

Aktualisht ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 8 (tetë) vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga informacioni i marrë në rrugë elektronike ka rezultuar se ngarkesa e znj. {...} ka në ngarkim çështje penale 61, të pezulluara 9, në konkluzione përfundimtare në çështje penale 19, në çështje civile ka në gjykim 132, të pezulluara 11, në konkluzione përfundimtare 4. Totali, në gjykim ka 193 çështje, të pezulluara 20, dhe në konkluzione përfundimtare 23. Gjithashtu ka në shqyrtim edhe 2 çështje si gjyqtare e caktuar me vendim të Këshillit për të gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, 1 në gjykatën e Kurbinit dhe 1 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Vlerësimi i Komisionit

Neni 45 i Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, rregullon institutin e skemës së delegimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistrati për t'u pranuar në këtë skemë, si dhe detyrimin e Këshillit për të miratuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit, duke parashikuar ndër të tjera se:

"1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t'u caktuar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill.

2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet.

3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t'u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori."

Në zbatim të nenit 45 të Ligjit 96/2016 Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 22 datë 07.02.2019, ka miratuar Rregulloren "Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit". Neni 4 i kësaj Rregulloreje parashikon kriteret e kandidimit në këtë skemë.

Bazuar në rrethanat e faktit të parashtruara më sipër, në lidhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në parashikimet e Vendimit nr. 22, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit, pra të caktimit të saj në këtë skemë pasi:

- gjyqtarja ka dhënë pëlqimin për t'u caktuar në skemën e delegimit;
- ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion;
- nuk ndodhet nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit;
- nuk ushtron funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit;
- është e caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin e saj pasi aktualisht rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë ushtrojnë funksionin 4 (katër) gjyqtarë, ndërsa organika e kësaj gjykate është me 5(pesë) gjyqtarë;
- nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e saj si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Sa më sipër, konkludohet se znj. {...} plotëson kriteret për t'u caktuar në skemën e delegimit.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares {...}.

2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 1 (një) vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

3. Përjashtimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore.

5. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë nga data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim, të kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.

2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit

të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 1 (një) vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

3. Përjashtimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancën paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore që ka në shqyrtim kjo gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

4.1 Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.

5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin e dytë që ka të bëjë me caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Edhe për këtë akt, fjalën ia jap sërish zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë, relacioni i radhës që është në vijimësi të relacionit që unë e parashtrova përpara kolegëve në këtë mbledhje, ka për objekt projektvendimin "Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar". Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin "Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}".

Në supozimin e miratimit të këtij projektvendimi, Komisioni i Zhvillimit të

Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit edhe projektvendimin "Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar". Projektvendimin e propozuar më parë e miratuam bashkërisht në këtë mbledhje.

Lidhur me këtë të fundit, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është situata në të cilën ndodhet Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila aktualisht është me një numër të kufizuar gjyqtarësh në detyrë në raport me organikën.

Në detyrë janë vetëm shtatë gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 16 gjyqtarë. Nga sa mund të konstatohet, numri i gjyqtarëve në detyrë të kësaj gjykate është i pamjaftueshëm duke mbajtur në konsideratë numrin e domosdoshëm të gjyqtarëve për përfundimin së gjykuari të një çështjeje që gjykohet me 1 ose me 3 gjyqtarë, por edhe ngarkesën e çështjeve në këtë gjykatë, ku sipas informacionit periodik më të fundit të dërguar në zbatim të Vendimit të Këshillit nr. 25/2019, për 6-mujorin e parë të vitit 2022, ngarkesa mesatare për gjyqtar në fund të kësaj periudhe ka qenë 25,3 çështje në shqyrtim.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka një ngarkesë çështjesh për secilin gjyqtar i cili është i parashikuar dhe i integruar në këtë relacion. Unë nuk do doja t'i lexoja një nga një ngarkesën e gjyqtarëve. Nëse kolegët janë dakord unë mund të vazhdoj më tej.

Gjithashtu, mbahet në konsideratë se kjo gjykatë në vijimësi ka paraqitur nevojë, për një numër të lartë çështjesh, për caktim gjyqtarësh nga gjykatat e tjera sipas Vendimit të Këshillit nr. 30/2019.

Vlerësimi i Komisionit

Në një situatë të tillë, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë të një numri të mjaftueshëm gjyqtarësh, çka do të mundësonte gjykimin normal të çështjeve të regjistruara përpara saj.

Meqenëse nj. {...}, në supozimin e miratimit nga Këshilli të projektvendimit për caktimin e saj në skemën e delegimit, do të jetë gjyqtare e kësaj skeme, nisur nga nevojat imediate të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin e saj në këtë

gjykatë, për të gjithë periudhën njëvjeçare të komandimit në këtë skemë.

Lidhur me këtë vlen të theksohet se gjyqtarja znj. {...} ka përvojë profesionale mbi 7 vjet, nga të cilat mbi 5 vjet në fushën e të drejtës penale, pra ka përvojën minimale profesionale që kërkon ligji, neni 47, pika 2, shkronja "a", i Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rrethanë kjo që i jep të drejtë Këshillit ta caktojë atë në këtë gjykatë për periudhën e caktimit në skemën e delegimit. Po ashtu, gjyqtarja {...} plotëson edhe kushtet shtesë të sigurisë për t'u caktuar pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar sipas shkronjës "b" të kësaj dispozite, sipas të cilës Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave "b) në një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ..., nëse magjistrati përmbush kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe jep pëlqimin sipas kërkesës së pikës 3, të nenit 47, të tij". Znj. {...} dhe familjarët e afërt të saj kanë plotësuar dhe dorëzuar rregullisht formularët e vetëdeklarimit për dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", në kuadër të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (për pozicionin e shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 287, datë 06.07.2021).

Struktura e Projektvendimit

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtarja e skemës e delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për periudhën deri më datë... e kemi lënë datën në varësi të diskutimit dhe të një konkluzioni që mund të arrijmë bashkërisht sepse kemi edhe atë periudhën tranzitore se kur duhet gjyqtarja të vijojë procedurën, gjykimet dhe përfundimin nëse do përfshihet, të caktohet pra në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, pikërisht deri në datën kur përfundon caktimi i saj në skemën e delegimit, pra në varësi të vendimmarrjes së Këshillit në lidhje me projektvendimin "Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}".

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data e përfshirjes së znj. {...} në skemën e delegimit.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Përcaktimi i këtij rregullimi merr në konsideratë faktin se kjo gjykatë ka buxhetin për të përballuar efektet financiare të vendimit, ndërsa ka pozicione të lira të përhershme, përveç edhe faktin se znj. {...} është kandidate e vetme për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 287, datë 06.07.2021.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën e saj elektronike zyrtare, si dhe një kopje e njoftimit t'i dërgohet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Së fundi në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi menjëherë e tij dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mbetet i hapur vetëm diskutimi përtej të tjerave, që është i paplotë nga ana jonë, pjesa e përcaktimit të datës deri kur duhet të shkojë, pra për vitin 2023 deri në çfarë date mund t'i lëmë afatin njëvjeçar.

Brikena Ukperaj: Unë kam një pyetje.

Afati ose caktimi i gjyqtares në skemën e delegimit për të gjykuar për llogari të GJKKO-së (Gjykata e Posaçme) do jetë në të njëjtën ditë që i prodhon efektet vendimi i caktimit në skemën e delegimit apo do kenë dy data të ndryshme?

Klodian Kurushi: Ne kemi menduar që mund të jenë dy data të ndryshme.

Brikena Ukperaj: Sepse këtu në relacion ke thënë ndryshe, ke thënë në pikën 2 që bën fjalë për fillimin e efekteve të vendimit pikërisht nga data e përfshirjes së zonjës {...} në skemë delegimi. Kur do ta caktojmë? Në këtë datën kur fillon skema e delegimit apo në një datë tjetër? Sepse sapo e miratuam vendimin e skemës së delegimit dhe thamë që

efektet juridike të vendimit të caktimit në skemë fillojnë nga dita e njoftimit. Pra ne duhet ta njoftojmë dhe në momentin që e njoftojmë ajo quhet e futur në skemë. Tani, kur do shkojë tek GJKKO-ja (Gjykata e Posaçme)? Se po u fut në skemë ajo duhet të shkojë menjëherë dhe ndërkohë vazhdon gjykimet për këto çështjet që kemi thënë ne.

Klodian Kurushi: Kam përshtypjen se po të futet në skemë ne nuk kemi probleme se nuk është se e heqim edhe nga gjykata ku ajo gjykon edhe nga gjykata ku ajo do shkojë.

Brikena Ukperaj: Prandaj po them. Këtë po them. Duke qenë se ne datën nuk e kemi të përcaktuar por kemi thënë "nga data e njoftimit të këtij vendimi", është i njëjti moment, kështu që nuk ka nevojë për të lënë afat ndoshta.

Do ta njoftojmë sot ne vendimin?

Klodian Kurushi: Po, do ta njoftojmë.

Nesër ajo futet në skemë.

Brikena Ukperaj: Që të hënën ajo është në skemë.

Klodian Kurushi: Përtej faktit që është në skemë, do përfundojë edhe ca çështje që mund t'i ketë në gjykatën..

Brikena Ukperaj: Ato i përfundon se është në skemë. S'ka problem.

Klodian Kurushi: Nuk është problemi për Lezhën, është problemi për Gjykatën e Krimeve të Rënda, apo jo?

Brikena Ukperaj: Është problemi për të përcaktuar datën se kur do fillojë aty dhe kur i mbaron. Në qoftë se do themi të njëjtën datë me skemën e delegimit dhe ne do t'ia njoftojmë sot, i bie që efektet e vendimit të fillojnë të hënën, që është data 27, ndoshta.

Marçela Shehu: Të hënën? – 17.

Klodian Kurushi: Po pra.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Brikena Ukperaj: E miratuam dhe sapo thamë që hyn në fuqi në ditën e njoftimit.

Marçela Shehu: Në momentin që e futëm në skemë, i ka filluar efekte dhe ne duhet ta çojmë.

Brikena Ukperaj: Kështu që nuk duhet të diskutojmë afat.

Klodian Kurushi: Ok, atëherë propozimi është, meqenëse sot jemi me 14, për të hënën.

Brikena Ukperaj: Për të hënën, se s'e kemi njoftuar.
Nga data e njoftimit. Po sot nuk e dimë kur do t'ia njoftojmë.

Klodian Kurushi: Mundet edhe elektronikisht.

Brikena Ukperaj: Nga data 17 e bëjmë, se s'ka problem.
Ajo dot t'i gjykojë ato, e kemi thënë tek vendimi i parë.

Klodian Kurushi: S'ka problem, edhe po të jetë në skemë ajo, do vazhdojë gjykimet në Gjykatën e Lezhës.

Brikena Ukperaj: Dakord. Por do lëmë një datë këtu ne.

Naureda Llagami: 17.10.2022 dhe këtu i bie 17.10.2023. Jemi dakord me datat e propozuara që efektet juridike të vendimit të fillojnë më datë 17.10.2022?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për periudhën deri më datë 17.10.2023.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 17.10.2022.

3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

7.1 "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit".

7.2 "Për përfundimin e procedurës së shpalljes së kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira".

7.3 "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në ministrinë e drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***

6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EËMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

7.1 "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit".

7.2 "Për përfundimin e procedurës së shpalljes së kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira".

7.3 "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në ministrinë e drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit".

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me "Për përfundimin e procedurës së shpalljes së kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së

Monitorimit të Profesioneve të Lira". Për më shumë detaje ia jap fjalën zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Atëherë, relacioni përkatës i prezantuar nga zonja Kryetare, ka për objekt miratimin e projektvendimit "Për përfundimin e procedurës së shpalljes së kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për kandidimin në Ministrinë e Drejtësisë për një pozicion, atë të Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira.

Rrethanat e faktit

Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. {...} prot., datë 13.01.2022, i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e 1 (një) magjistrati gjyqtar në pozicionin vakant të shërbimit civil, përkatësisht për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira.

Në këtë kërkesë Ministria ka përcaktuar edhe kriteret specifike për pozicionin. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, mbi bazën e kësaj kërkese ka propozuar dhe paraqitur në Këshill, projektvendimin "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit".

Ministria e Drejtësisë, ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor një kërkesë të re, nr. {...} prot., datë 10.10.2022, me anë të së cilës kërkohet komandim magjistrati në pozicion vakant të nivelit të lartë drejtues, në pozicionin: Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Me njoftimet elektronike të datave 11.10.2022 dhe 13.10.2022 institucioni kërkues, njofton se: "...Tërhiqemi nga kërkesa nr. {...} prot., datë 13.01.2022 "Kërkesë për komandim magjistrati në pozicionin vakant të shërbimit civil", me anë të secilës është kërkuar plotësimi i vendit vakant pjesë e shërbimit civil Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira, nëpërmjet komandimit të një magjistrati për një periudhë 5-vjeçare."

Në vijim të procesit të komandimit, Ministria e Drejtësisë, duke tërhequr kërkesën nr. {...} prot., datë 13.01.2022, pra kërkesën e parë për komandim, i qëndron vetëm kërkesës nr. {...} prot., datë 10.10.2022 "Kërkesë për komandim magjistrati në pozicionin vakant të nivelit të lartë drejtues", me anë të secilës kërkohet komandimi i një magjistrati në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit".

Vlerësimi i Komisionit

Në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, gjejmë këto parashikime ligjore lidhur me fillimin dhe mbarimin e një procedure administrative:

Neni 41 i K.Pr.Administrative shprehet se: "1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës; b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik. 3. Procedura administrative konsiderohet e filluar: a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose b) me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë"

Në nenin 64 të K.Pr.Administrative, parashikohet e drejta e një pale të procedimit administrativ për t'u tërhequr nga ky procedim me anë të kërkesës së paraqitur prej tij, duke parashikuar ndër të tjera se: "... 2. Një palë, me anë të një kërkese me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore përveç rasteve kur ajo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e treta, nëse ka. 3. Vendimi i organit publik për t'i dhënë fund procedurës administrative, pas tërheqjes së njërës prej palëve, mund të ankimohet nga çdo palë tjetër...".

Ndërsa nenet 90-96 të ligjit të sipërcituar trajtojnë përfundimin e procedurës administrative dhe rastet e përfundimit të saj. Kështu neni 90 shprehet se : "1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij. 2. Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji. 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e

parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ".

Ndërsa neni 94 i K.Pr.Administrative parashikon tërheqjen nga kërkesa si një nga rastet e përfundimit të procedurës administrative të nisur me kërkesë, duke u shprehur se: "1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë. 2. Organi publik mund të deklarojë përfundimin e procedurës së nisur me kërkesë, pa vendim përfundimtar edhe nëse rezulton qartazi nga rrethanat se pala që ka paraqitur kërkesën, nuk ka më interes për vazhdimin e procedurës dhe e ka braktisur atë...."

Bazuar sa më sipër, referuar faktit se: i) në rastin konkret jemi para një procedure administrative të filluar me kërkesë të subjektit, Ministria e Drejtësisë; ii) kjo e fundit është tërhequr nga kërkesa e paraqitur prej saj; iii) Këshilli nuk ka disponuar me një vendim përfundimtar lidhur me këtë kërkesë; vlerësohet se në rastin konkret jemi në kushtet e deklarimit të përfundimit të procedurës administrative të nisur me kërkesë nga Ministria e Drejtësisë.

Për sa më sipër, me cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Përfundimin e procedurës së shpalljes së kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira".

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, vijojmë me...

Klodian Kurushi: Vetëm diçka për merak më tepër. Në projektvendim, në pikën e dytë të projektvendimit kemi vendosur "Kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit". Është edhe në rastin e përfundimit të procedurës pa vendim. Kundër këtij vendimi në ligj parashikohet e

drejta e ankimit dhe kjo është arsyeja pse e kemi vendosur si dispozitë formale konkrete në këtë rast. E kërkonte ligji dhe prandaj e kemi vendosur.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së shpalljes së kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira", për shkak të tërheqjes së institucionit kërkues nga kjo kërkesë.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit. Për më shumë detaje fjalën ia jap sërish zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së drejtësisë" dhe në zbatim të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 13.01.2022, Ministria e Drejtësisë, i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e 1 (një) magjistrati gjyqtar në pozicionin vakant të shërbimit civil, bëhet fjalë për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira.

Ministria e Drejtësisë në kohë të ndryshme ka kërkuar plotësimin e vendeve vakante në shërbimin civil, për disa pozicione. Kërkesat për kandidatura janë shpallur nga Këshilli dhe rishpallur disa herë, por kanë rezultuar pa kandidatë.

Me vendimin nr. 281, datë 10.12.2019 të KLGJ-së kemi një kërkesë për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen , kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit. Kërkesa e dytë është me vendimin nr. 100/2020 për rishpallje edhe një herë të kërkesës.

Në lidhje me rastin në shqyrtim, me kërkesën nr. {...} prot., datë 13.01.2022, Ministria e Drejtësisë i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e 1 (një) magjistrati gjyqtar në pozicionin vakant të shërbimit civil, përkatësisht për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira.

Vlerësimi i Komisionit

Për sa më sipër, mbështetur në nenin 86, shkronja "d", të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshilli të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit".

Kemi parashikuar më pas në këtë vendim kohëzgjatjen, kriteret e vendosura dhe procedura e kandidimit në atë pozicion.

Vetë projektvendimi përbëhet nga kreu i parë, kreu i dytë, kreu i tretë.

Ky është propozimi ynë, për të shpallur një vend vakant, të kërkuar nga Ministria e Drejtësisë në pozicionin e "Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Brikena Ukperaj: Një pyetje kam Kryetare.

Lidhur me kriteret e pozicionit, i ka përcaktuar Ministria e Drejtësisë kriteret? Se unë nuk e kam shkresën Klodi, por na është dërguar me e-mail.

Klodian Kurushi: Qartë. Ato kanë përcaktuar kriteret që duhet të jetë magjistrat (të ketë mbaruar Shkollën e Magjistraturës) dhe të ketë një përvojë pune jo më pak se 1 vit si magjistrat në detyrë. Këto ishin kriteret.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1.Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit";

2. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është data 31 tetor. [...]

II. Kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit

1. Kohëzgjatja e komandimit, në pozicionin e shpallur, është deri në 5 (pesë) vjet.

4. [...] a) kandidati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe b) duhet të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit për të paktën 1 vit me përvojë pune në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm civil dhe penal.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në pozicionin "këshilltar".

Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Relacioni i radhës "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së drejtësisë" i ndryshuar, është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si

dhe çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji nr. 96/2016, i ndryshuar, ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magjistratit, me pëlqimin e tij, në institucione brenda sistemit të drejtësisë, si dhe organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu në dispozitat e këtij ligji, konkretisht në nenet 54 – 58, përcaktohet edhe procedura që duhet të ndjekë Këshilli, ashtu dhe institucionet e tjera në të cilat magjistrati mund të komandohet, në këto raste.

Në lidhje me rastin në shqyrtim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor u depozitua shkresa nr. {...} prot., datë 26.07.2022, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes të cilës Këshillit iu kërkua komandimi i dy (2) magjistratëve gjyqtarë në pozicionin këshilltarit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Theksojmë se kërkesat e mëparshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pozicione të lira si inspektor, kanë rezultuar pa kandidatë pavarësisht rihapjes disa herë nga Këshilli.

Sjell në vëmendje, kemi: vendimin nr. 98/2020; vendimin nr. 249, datë 09.07.2020; vendimi i fundit nr. 572, datë 07.12.2021; pra tre herë raste të përsëritura për shpallje vendesh dhe janë të dështuara si procedura dhe që nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë.

Vlerësimi i Komisionit

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se kërkesa nr. {...} prot., datë 26.07.2022, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për këshilltar/pozicione të tjera përfshihen (sipas mendimit tonë, por kemi edhe mendime ndryshe brenda komisionit) në rrethin e institucioneve brenda sistemit të drejtësisë, dhe vlerësohet hapja e procedurës për komandim për 1 (një) pozicion këshilltar (nga dy).

Ndaj sa më sipër, mbështetur në shkronjën "ë", pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën "a", pika 2, të nenit 61, në shkronjën "d" të nenit 86, në shkronjë "b", pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas Shkresës

nr. {...} prot., datë 26.07.2022, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar Projektvendimin "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit".

Kreu I i projektvendimit, pika 1, bën fjalë për shpalljen e kërkesës për kandidatura, duke u përcaktuar se kërkesa shpallet për plotësimin e 1 (një) pozicioni vakant: një pozicion "Këshilltar, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".

Në pikën 2, parashikohet afati i paraqitjes së kërkesave, që përcaktohet jetë dy javë nga shpallja e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor,– ose një datë fikse e përcaktuar, të paktën 15 ditë nga mbledhja e Këshillit që do të shqyrtojë këtë projektvendim. Ligji e ka minimumi 2 javë afatin nga shpallja deri tek mbledhja e të gjithë kërkesave që mund të bëjnë kandidatët magjistratë. Ose në mënyrë alternative, se nuk dinim se kur mund të mbahej, themi 15 ditë (ne mund ta caktojmë bashkërisht), nga dita e sotme, ose të hënën mbas dy javësh.

Në pikën 3 të këtij Kreu, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati, konkretisht: kërkesë për komandim; jetëshkrim; diplomë për fitimin e titullit magjistrat, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kritereve të komandimit.

Në Kreun e dytë të projektvendimit, përcaktohet kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit të gjyqtarit.

Sipas pikës 1 të këtij Kreu, kohëzgjatja e komandimit, në këtë pozicion të shpallur, përcaktohet të jetë deri në 5 (pesë) vjet, pra sipas afatit të kërkuar nga institucioni kërkues, afat ky që është brenda limitit maksimal të përcaktuar nga ligji, pika 5, e nenit 53, të Ligjit nr.96/2016.

Në pikën 2 të këtij Kreu, përcaktohen rastet e përfundimit të komandimit para afatit, në pozicionin e shpallur, konkretisht kur: a) kërkohet nga vetë gjyqtari për shkaqe të justifikuara (përderisa komandimi është me pëlqim), si dhe kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit, pra kur verifikohet kushti kryesor i komandimit.

Më tej, në pikën 3 të këtij Kreu, jepen kushtet e komandimit, në pozicionin e shpallur, të përcaktuara nga neni 53 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konkretisht: a) komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës... ; b) kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; c) kandidati nuk duhet të jetë i komanduar; ç) kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit dhe d) kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Në pikën 4 të Kreut II, jepen kriteret e komandimit për pozicionin "Këshilltar", që është: a) kandidati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës; - duke mbajtur në vëmendje gjendjen e sistemit, kushtet për promovimin e magjistratëve, Komisioni vlerëson të parashikojë kriterin që kandidatët të kenë jo më pak se 2 (dy) vjet eksperiencë.

Në pikën 5 të këtij Kreu, përcaktohet dokumentacioni që do të shërbejë për vlerësimin nga Këshilli të kushteve dhe kritereve të kandidimit, konkretisht parashikohet që Këshilli mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Në pikën 6 të Kreut II, përcaktohet procedura që do ndiqet, nga i Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për vlerësimin e plotësimit të kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë. Ky vlerësim do bëhet brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit. Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, i cili shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 7 të këtij Kreu, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë aplikimet e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për komandimin në pozicionin "Këshilltar".

Në pikën 8, parashikohet se, brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin, në pozicionin respektiv të kandidatit të përzgjedhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Ndërkohë në pikën e fundit të Kreut (9), rregullohet situata ligjore kur asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet dhe kriteret e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në këtë rast,

pas njoftimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe mbi kërkesën e tij, Këshilli mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit "Këshilltar", në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Së fundi, parashikohet se ky vendim hyn në fuqi dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe u komunikohet gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim lidhur...

Alban Toro: Kam unë.

Naureda Llagami: Po!

Alban Toro: Atëherë.

Meqë vendimi është me shumicë, do shpreh mendimin kundër vendimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në lidhje me rastin në shqyrtim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar Shkresa nr. {...} prot., datë 26.07.2022, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes të cilës Këshillit i kërkohet komandimi i dy (2) magjistratëve gjyqtarë në pozicionin këshilltar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Kushtetuta në dispozitat e saj të përfaqësuar nga neni 135 e në vijim ka konfiguruar statusin e gjyqtarëve i cili synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve.

Pjesë e garantimit të statusit të gjyqtarëve është ligji nr. 96/2016 i cili ndër të tjera ka përcaktuar edhe Institutin e komandimit, parimet e përgjithshme të komandimit të magjistratëve, në rastin konkret gjyqtareve, në pozicione të ndryshme nga ai i funksionit të gjyqtarit, kjo edhe si një garanci, vlerë e shtuar për gjyqtarin dhe institucionin ku ai debuton.

Në nenin 53 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen parimet e përgjithshme ku me:

1. “Komandim” konsiderohet lëvizja e magjistratit në një pozicion jo magjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, pozicion i cili është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij.

2. “Institucioni në të cilin magjistrati komandohet”, për pozicionin e ndihmësmagjistratit është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit.

Nga sa më lart nënkuptohet se komandimi i magjistratit do të jetë lëvizjen e tij në një pozicion jo magjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, pozicion i cili është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij.

Duke i konsideruar si njohës të mirë të ligjit, ligjvënësi ka dashur që nëpërmjet angazhimit të gjyqtarëve në institucione të drejtësisë, ata të përcjellin eksperiencën dhe saktësinë e interpretimit të ligjit në këto institucione, të cilat me pas i ka përcaktuar në pikën 2 të nenit 53, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit publik dhe sistemit të drejtësisë por nga ana tjetër edhe vetë gjyqtarët shndërrohen si përfitues të eksperiencës gjatë ushtrimit të profesionit në vendet ku komandohen.

Përkufizimi i nenit 2 të Ligjit për Statusin plotësuar me parashikimet e pikës 1 dhe 2 të nenit 53 të tij, në mënyrë shteruese dhe gjithë përfshirëse përcakton institucionet në të cilat magjistrati mundet të komandohet, përfshirë të gjitha kategoritë e magjistratëve të komanduar.

Më lart citova pikën 2 të nenit 53 të Ligjit për Statusin i cili la përcaktuar tre kategori apo figura të magjistratëve të komanduar, kategoria e parë – mdihmësmagjistratët të komanduar pranë Gjykatës së Lartë (shkronja h e nenit 2 të ligjit për Statusin), kategoria e dytë – magjistratët e komanduar si inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe kategoria e tretë – magjistratët e komanduar në institucionet e tjera ku lejohet komandimi i magjistratëve, të ndryshme nga kategoritë e para.

Më tej pika 2 e nenit 53 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokuroreve”,

përcakton institucionet në të cilën komandohen gjyqtarët, por duke mos përcaktuar nominalisht detyrën përkatëse që duhet të mbulojë.

Më lejoni të kufizohem tek kategoria e dytë e komandimit për të cilin ligji ka përcaktuar se gjyqtaret komandohen vetëm në një pozicion të përkohshëm si inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pasi neni 53 dhe 54 i Ligjit nr. 96/2016 rregulloi çështje të një natyre të përgjithshme mbi institutin e komandimit të magjistratëve, neni 55 i kushtohet në mënyrë të posaçme kategorisë të magjistratëve të komanduar dhe vetëm njërit institucion ku ato komandohen, pra magjistratëve të cilët komandohen si inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në të nuk ka parashikime të përgjithshme por në mënyrë shteruese ka përcaktuar vetëm një figurë komandimi pranë ILD-së atë të inspektorit pranë Zyrës së ILD-së.

Neni 55 i këtij ligji ka për qëllim të përcaktojë në mënyrë të detajuar kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit të magjistratëve si inspektorë pranë ILD-së. Kjo dispozitë duhet të shihet si e pandarë dhe plotësuese bashkë me dispozitat e tjera që parashikohen në Ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në pjesën që rregullon Zyrën e ILD-së. Neni 55 i Ligjit për Statusin rregullon në mënyrë të posaçme komandimin e magjistratëve, gjyqtarë dhe prokurorë pranë Zyrës së ILD-së si inspektorë. Në këtë dispozitë specifikohen kushtet dhe kriteret e posaçme të komandimit të magjistratëve si inspektorë, duke vendosur theksin tek rëndësia që ka krijimi i këtij organi të ri kushtetues, në efektin që ka komandimi pranë këtij organi për karrierën e magjistratit (paragrafi 3 i nenit 55 i Ligjit për Statusin). Madje në këtë aspekt garancitë statuore kanë parashikuar pagën e magjistratit e përfituar gjatë periudhës së komandimit pranë këtij institucioni por edhe në figurat e tjerë të komandimit.

Në këtë kuadër, neni 210 i Ligjit "Për organet e drejtësisë" ka parashikuar një skemë tjetër page për inspektorët magjistratë /gjyqtarë të komanduar pranë Zyrës së ILD-së. Kjo normë parashikon se: " 1. Inspektorët magjistratë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përfitojnë pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të gjykatës së apelit. ".

Ndërkohë që për figurat e tjera të komandimit vijon si me poshtë:

Për ndihmësmagjistratët, që do të thotë magjistratët e komanduar pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë ligjet e posaçme organike parashikojnë se ato do të

paguhen si gjyqtarë të shkallës së parë, nëse vijnë nga gjykata e shkallës së parë, dhe si gjyqtarë të gjykatave të apelit, nëse vijnë nga gjykatat e apelit.

Magjistratët e komanduar si pedagogë të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës, sipas nenit 264 pika 3 e Ligjit për organet e drejtësisë, parashikohen se gjatë periudhës së komandimit do të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe privilegjet e gjyqtarit të gjykatës së apelit.

Gjithashtu ligji ka parashikuar edhe numrin maksimal të magjistatëve/gjyqtarë i cili duhet të përbejë stafin e inspektorëve. Pika 1 e nenit 209 të ligjit "Për organet e drejtësisë", parashikon se jo më pak se gjysma e inspektorëve të Zyrës së ILD-së duhet të jenë magjistratë. Kjo dispozitë parashikon se magjistratët gjyqtarë komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe se magjistratët prokurorë komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Qëllimi i ligjit në përcaktimin e numrit të magjistratëve/gjyqtarë – prokurorë pranë ILD-së është se kjo e fundit është përgjegjës për zhvillimin e hetimit disiplinor edhe të gjyqtarëve edhe të prokurorëve.

Ndërkohë që për institucione të tjera ku magjistratët mundet të lëvizin përkohësisht me anë të komandimit, këto, ligji ka përcaktuar ne mënyrë shteruese Institucionet si: KLGJ, Ministrinë e Drejtësisë, Avokaturën e Shtetit, Shkollën e Magjistraturës dhe çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë ose në institucionet e përafrimit të legjislacionit, të cilat mund të jenë Kuvendi, Ministria e Jashtme, Ministria e Integrimit apo Presidenti, të cilat duken se kanë struktura të posaçme të hulumtimit dhe përpunimit të informacionit mbi procesin e përafrimit të legjislacionit.

Përfundimisht komandimi i magjistratit/gjyqtar në një pozicion "këshilltar" kur dispozita e posaçme nuk e ka të parashikuar këtë figurë komandimi është në kundërshtim me ligjin për statusin e si e tillë nuk mund të pranohet. Në rast të komandimit të tij ai do të cenohej dukshëm edhe në pagë. Këshilltari pranë ILD-së, pozicioni për të cilën kërkohet komandimi i gjyqtarit, ka pagën e Zëvendësministrit 153.300 lekë, ndërkohë që inspektori magjistrat ka pagën e kategorisë G2 (gjyqtar apeli) me pagë 250.074 lekë dhe mbi pagën referuese 126.300 lekë x 2 % vjetërsi, i shtohet vlerës së përgjithshme që ka tendencë për t'u rritur.

Kështu që duke marrë të gjithë elementët: figurë–pagë–pozicion, dalim jashtë parashikimit ligjor dhe si i tillë, propozimi apo kërkesa e Inspektorit nuk mund të

pranohet, se vjen në kundërshtim me ligjin.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim tjetër?

Po!

Brikena Ukperaj: Problemi që ngre Albani në fakt kërkon vëmendje të veçantë nga ana e Këshillit në kushtet kur për herë të parë, ne sot, po shpallim kërkesa për komandim në pozicione që nuk parashikohen në ligj, - sipas Albanit, dhe vlerësoj që kjo kërkon një analizë të thelluar të dispozitave ligjore, jo vetëm të ligjit për Statusin por edhe të ligjit "Për organet e qeverisjes" ku flitet për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sepse kërkohet komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në pozicionin "këshilltar".

Marrë parasysh këtë gjë si dhe nga ajo që unë konstatoj, shikoj që në fakt kriteret nuk i ka përcaktuar Inspektori por i ka përcaktuar Komisioni në rastin konkret. Pra ndryshe nga Ministria e Drejtësisë e cila në kërkesën e saj kishte të përcaktuar edhe kriteret e pozicionit, që thoshte "të kishte mbaruar Shkollën e Magjistraturës dhe të kishte 2 vjet eksperiencë", në shkresën e ILD–së nuk konstatoj që të jenë caktuar kriteret e pozaicionit, por ka të përcaktuar vetëm periudhën maksimale të kohëzgjatjes së komandimit. Prandaj unë propozoj që të shtyhet diskutimi i çështjes, t'i kërkohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të përcaktojë kriteret e këtij komandimi dhe unë nuk e kam shkresën në praktikën që më është përcjellë. Njëkohësisht edhe ne të reflektojmë edhe mbi çështjet e ngritura nga Albani, sepse është një analizë që ndoshta nuk mund ta marrim dot, dhe për sa kohë nuk e kemi pasur as në relacion, është një analizë që duhet parë me hollësi.

Alban, unë nuk isha përgatitur për këtë diskutim. Për këtë diskutim nuk isha përgatitur.

Naureda Llagami: Atëherë, propozimi i Brikenës është që në kuadër të praktikës që ka bërë Këshilli, gjithmonë lidhur me pjesën e komandimeve të magjistratëve në pozicione në institucione të tjera të sistemit të drejtësisë, është që, duhet që nga

institucioni që kërkon komandimin, të caktohen edhe kriteret që duhet të ketë kandidati magjistrat. Kështu që propozimi i Brikenës është që në eventualitetin që tek shkresa e përcjellë nuk janë përcaktuar nga institucioni, pavarësisht se janë përcaktuar tek projekt-akti, puna është që të konfirmohen nga institucioni, se cilat janë kriteret që duhen për kandidatin për magjistrat që do komandohet.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e zonjës Ukperaj.

Irena Plaku: Pro propozimit.

Dritan Hallunaj: Pro, pasi kjo ka qenë pjesë e diskutimeve të gjata që janë bërë në Komision, dhe kemi pasur edhe ne disa.... dhe pikërisht kjo ishte arsyeja që e sollëm në mbledhjen plenare që ta trajtonim të gjithë bashkë.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër për shkak se aktualisht kërkesa vjen në kundërshtim me dispozitat ligjore, qoftë për ligjin për statusin, qoftë me ligjin për qeverisjen. Kështu që, në këtë kuadër, duke qenë se është problem ligjor, dhe që nuk mund të përmbushet nga ana jonë, nuk ka nevojë për veprime të tjera procedurale, vetëm për interpretim të ligjit. Kështu që jam kundër.

Fatmira Luli: Pro, meqenëse gjykohet që duhet të marri kohë dhe të trajtohet dhe të shihet më me kujdes kush janë kriteret dhe nëse vendi që kërkohet të komandohet është nga ato vendet që i lejohet një gjyqtari të shkojë të punojë tek ILD–ja.

Marçela Shehu: Dakord që t'i kërkohet ILD–së të përcaktojë kriteret bazuar në të cilat do të bëhet edhe shpallja e pozicionit përkatës, sigurisht, në rastin eventual që do të pranohet nga Këshilli, si dhe vlerësoj që të shtyhet për t'i dhënë mundësi të gjithë atyre anëtarëve që nuk ishin të gatshëm sot që të shpreheshin lidhur me propozimin. Jam dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin e fundit. Vetëm ne do t'i drejtohemi Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me sa kuptoj, për të përcaktuar kriteret, por mos duhet ta orientojmë se çfarë kriteresh... do d.m.th kritere vetëm për vjetërsinë apo edhe ndonjë kriter tjetër apo thjesht vetëm të dërgojmë shkresën? Vetëm për kaq?

***Brikena Ukperaj*:** Vetëm cilat janë kriteret.

Klodian Kurushi: Se mos duhet ta orientojmë për çfarë...?

*(**Naureda Llagami**: Edhe brenda nesh, rasti i Maelës, kemi bërë kritere Sekretarit të Përgjithshëm për komandimin.)*

Naureda Llagami: Edhe unë jam dakord që të shtyhet dhe në një kohë sa më të shpejt të merret komunikimi me zyrën e institucionit për të përcaktuar kriteret sipas ligjit dhe për t'i lejuar Këshillit që ta trajtojë me përparësi këtë çështje.

Atëherë çështja shtyhet.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

***Pika 9 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në aktet e tjera.

Akti tjetër ka të bëjë me miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata.

Në fakt është një akt që ka ardhur nga Komisioni i Administrimit të Buxhetit dhe që do të relatohet nga zoti Kelment Greca i cili është edhe drejtori.

Kelment Greca: Përshëndetje!

T'i bie shkurt?

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka një detyrim për miratimin e listave tip. Lista që është sot në fuqi është me një vendim të Ministrit të Drejtësisë. Me hyrjen në fuqi të ligjit 115 dhe 98, ngarkon KLGJ-në për miratimin e këtyre listave tip. Përgjithësisht, me marrjen e të gjithë kompetencave nga Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, me urdhër të Kryetares u ngrit një grup pune. Tek grupi i punës ishin përfshirë kancelarët e rretheve

gjyqësore Tiranë, Durrës dhe sekretarët gjyqësorë dhe kryesekretarë dhe një kancelar i gjykatës së apelit Tiranë. Grupi i punës mbasi prodhoi listat tip, i bëmë një shpërndarje të 38 gjykatave. Fillimisht nuk u mor ndonjë "feedback" nga ata. Ia ripërsëritëm kërkesën për të na dhënë mendim mbi listat tip. Në dërgimin e shkresës së dytë patëm më shumë reagime. I reflektuam këto reagime dhe kemi prodhuar këto listat tip. Listat tip kryesisht janë me afatet e ruajtjes së dosjeve, nuk bëhet fjalë për vendime gjyqësore. Vendimet gjyqësore janë me ruajtje të përhershme. Vetëm dokumentacioni shoqërues që ka dosja, që e ka humbur rëndësinë arkivore, është propozuar të asgjësohet. Kjo sjell edhe një gjë të mirë për gjykatat se deri tani nuk është asgjësuar asnjëherë. Kjo ka sjellë ngarkesë të tepruar të arkivave gjyqësore, që është e panevojshme për të mbajtur dokument të panevojshëm në këto arkiva. Prandaj dhe propozuam Komisionit dhe Komisioni ka propozuar këto listat tip që janë bashkëngjitur dhe janë shpërndarë anëtarëve.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Keni ndonjë pyetje?

Brikena Ukperaj: Jeni konsultuar me ligjin "Për arkivat"?

Kelment Greca: Po, po!

Kanë shkuar në gjykata dhe kanë bërë inspektime.

Edhe një sqarim, pavarësisht gjësë, është një komision pranë gjykatës, komisioni i ekspertizës, që e kryeson kryetari, zëvendëskryetari, kancelari, për asgjësimin ngrihet komisioni dhe bën vlerësimin për asgjësimin e këtyre dosjeve, pastaj asgjësohen. Kjo është një ndihmesë, këto komisionet e ekspertizës që ngrihen në këto gjykata, që e kanë detyrim ligjor sipas ligjit të arkivave.

Kjo ka marrë gati 1 vit, duke u bërë të gjitha konsultimet me të gjitha gjykatat, dhe janë prodhuar këto dokumentacione.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Nëse nuk keni diskutime të tjera, ftoj kolegët në miratimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata" sipas anekseve bashkëngjitur, pjesë e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

***Pika 10 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektudhëzimit "Për përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur, nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektudhëzimit "Për përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur, nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë edhe tek projekt-akti tjetër, që edhe ky ka të bëjë me përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur, nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë. Ky është një nga detyrimet që na vjen për shkak të Kodit Penal për të mitur. Prapë sërish fjalën dëshiroj t'ia jap drejtorit të departamentit për të sqaruar lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit.

Kelment Greca: Përveç detyrimeve që rrjedhin nga Kodi, në zbatim të Kodit ka dalë edhe një vendim i Këshillit të Ministrave që detyron Ministrinë e Drejtësisë të ngrejë dhe të administrojë regjistrin për të mitur, njëkohësisht detyron edhe gjykatat dhe KLGJ-në të dalin me akte për miratimin e formularëve dhe një udhëzimi për të plotësuar/pasuruar sistemin që administrohet nga AKSH-i (është një sistem 'web' i

bazuar në web-faqe). Secila gjykatë futet tek kjo faqe dhe hedh të gjitha të dhënat e nevojshme për drejtësinë për të mitur, siç e detyron edhe Kodi. Templejtet që kanë bashkëngjitur këto janë të dala nga sistemi, domethënë janë të detyrueshme për t'u miratuar siç e ka sistemi. Sistemi është prodhuar dhe është në funksion. Mbështetëse e të gjithë projektit është edhe UNICEF-i. UNICEF-i ka dërguar një shkresë pranë KLGJ-së. Ne kemi mbledhur personat përgjegjës nëpër gjykata që do ta përdorin sistemin. Janë trajnuar si do të përdoret sistemi dhe ka mbetur vetëm pjesa e miratimit të këtij dokumenti që të kalohet nëpër gjykata dhe gjykatat të vazhdojnë me përdorimin dhe pasurimin e tij.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Keni ndonjë pyetje?

Nëse nuk ka pyetje, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e udhëzimit "Për përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur, nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë", sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Përpara se të kalojmë tek tre aktet e tjera, pesë minuta pushim.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

***Pika 11 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relatore Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relatore Irena Plaku).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Në vijim të rendit të ditës, mbledhjen në vijueshmëri po e drejtoj unë për faktin, sepse Kryetarja kishte një angazhim pune.

Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën 11 të saj, duke ia dhënë fjalën për më tej relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po ju paraqes relacionin lidhur me projektvendimin "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për gjyqtaren {...}".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016,

Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, me vendimin nr. 22, datë 17.01.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për gjyqtaren znj. {...}. Në këtë vendim jam caktuar unë si relatore dhe nëpunëse përgjegjëse znj. Gilda Hoxha.

Në datën 18.01.2022, është njoftuar gjyqtarja lidhur me këtë procedurë të filluar. Kjo e fundit ka konfirmuar marrjen dijeni të vendimit dhe nuk ka paraqitur as kundërshtime lidhur me këtë vendim.

Në vijim të procedurës së vlerësimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtares, ka rezultuar se:

Znj. {...} në periudhën tetor 2013 – korrik 2016 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga nëntori 2015 deri në muajin korrik 2016 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është dekretuar me dekretin e Presidentit të Republikës me nr. {...}, datë 20.11.2015. Me vendimin nr.13, datë 21.02.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...} është caktuar të ushtrojë funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, znj. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtares vetëm në periudhën e kryerjes së praktikës profesionale në vitin tretë të Shkollës së Magjistraturës, nga muaji nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016, për një kohëzgjatje prej 8 muajsh e 11 ditë. Ndërsa ajo është caktuar për të ushtruar funksionin e gjyqtares vetëm në datë 21.02.2017 (jashtë periudhës së vlerësimit).

Sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në ligjin i kohës nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar që:

“Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

a) Një vit programi teorik;

b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari;

c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuara nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori.

Në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohej se:

“Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën "b" të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magjistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.”

Ndërsa në nenin 19/1 parashikohej se: “Vlerësimi i këshillit pedagogjik bëhet me 5 shkallë: [...].

Lidhur me vlerësimin e vitit të tretë, në nenin 20, paragrafi i parë i ligjit, parashikohej se:

“Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit.”

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor të kohës, referuar më sipër, rezulton se periudha e stazhit profesional, e cila zhvillohej gjatë gjithë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, ka qenë pjesë integrale e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtares gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të detyrës, i është nënshtruar vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, në përfundim të të cilit më pas gjyqtarja ka pasur edhe statusin e gjyqtarit dhe është caktuar si gjyqtare.

Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për një periudhë të caktuar vlerësimi, nuk mund të mbivendoset me vlerësimin që bën vetë Shkolla e Magjistraturës, për të njëjtën periudhë vlerësimi, për kandidatët e vitit të 3-të Shkollës së Magjistraturës, për shkak se edhe pse për të njëjtën periudhë, kandidati i vitit të 3/të sipas ligjit të kohës, ka pasur statusin e gjyqtarit.

Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën vlerësimit 2013–2016, mbështetet në nenin 171, pika 5 të Ligjit për Statusin. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Shkalla e kësaj aftësie në nivelet: “shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë” apo

“mjaftueshëm” përcaktohet në procesin e gradimit.

Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas ligjit kur është e mundur.

Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, pas emërimit të znj. {...}, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2013–2016, rezulton se ajo nuk është caktuar dhe nuk ka ushtruar detyrën si gjyqtare gjatë periudhës së vlerësimi, pasi ajo është caktuar si gjyqtare për të ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datë 21.02.2017, pra jashtë periudhës së vlerësimit. Edhe nëse gjyqtarja do të ishte caktuar gjatë ushtrimit të detyrës direkt pas përfundimit të stazhit profesional, përsëri periudha e mbetur, pra gusht – tetor 2016 por edhe duke e marrë të plotë vitin 2016 për efekt të periudhës së vlerësimit, kohëzgjatja e detyrës së gjyqtares do të përkonte me 5 muaj.

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 është përcaktuar se:

1. Për çdo gjyqtar përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84... [...]. 4. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit.”

Referuar sa më sipër rezultoi se gjyqtarja nuk asnjë vit pune pas përfundimit të periudhës trevjeçare që përfshin Shkollën e Magjistraturës.

Sa më sipër, kur gjyqtarja nuk ka ushtruar veprimtari profesionale brenda periudhës së vlerësimit, rezulton se, objekti për të cilin ka filluar procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) është i pamundur të realizohet dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure vlerësimi nuk mund të vazhdojë.

Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtares. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97, pika 3, të ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli zbaton K.Pr.A., në nenin 95 të së cilit parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa

një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

Në rastin konkret, me konstatimin e mungesës së kushteve ligjore për të përcaktuar si periudhë të plotë vlerësimi, periudhën 3-vjeçare 2013 – 2016 (që përkon me periudhën e gradimit), realizimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional sipas nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, rezulton të jetë objektivisht i pamundur. Për pasojë vijimi i procedurës me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, nuk mund të vazhdojë. Ndërkohë që Këshilli ka vendosur vijimin e procedurës së vlerësimit për vitet 2017 – 2019 për të njëjtën gjyqtare.

Gjyqtarja është njoftuar lidhur me këtë projektvendim në datën 10.10.2022 dhe me e-mailin e datës 13.10. ka deklaruar se nuk ka kundërshtime. Është njohur me vendimin dhe nuk ka kundërshtime, dhe nuk ushtron të drejtën për t'u dëgjuar në plenare.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për shkak se objekti për të cilën kishte nisur kjo procedurë është i pamundur të realizohet, pasi gjyqtarja nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtares gjatë kësaj periudhë vlerësimi, pas përfundimit të stazhit profesional, periudhë e cila ka qenë objekt i vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të cilës ajo ka bërë pikëzimin dhe renditjen e magjistratëve me qëllim caktimin e tyre në detyrë.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për përfundimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar t'i njoftohet gjyqtares {...}.

Në pikën 3 parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual të Këshillit.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Keni diskutime mbi vendimin përkatës?

Atëherë, kalojmë në votimin e tij.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtaren {...}".

Këshilli i lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

***Pika 12 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qellim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relatore Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

10. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qellim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relatore Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 12 të rendit të ditës duke ia dhënë fjalën relatores zonjës Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar kolegë! Paraqes relacionin mbi projektvendimin "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qellim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 "Për miratimin e

rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve", me vendimin nr. 22, datë 17.01.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit është edhe z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në vijim të procedurës së vlerësimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtarit, ka rezultuar se Z. {...} në periudhën tetor 2012 – shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2014 deri në muajin gusht 2015 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 23.06.2016 ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sa më sipër, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, z. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në dy periudha:

A. Praktikën profesionale të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës nga muaji tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, për një kohëzgjatje prej 11 muajsh;

B. Funksionin e gjyqtarit për periudhën 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë.

Sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, ligji i kohës nr.8136, datë 31.07.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 14 parashikonte se: "Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

a) një vit programi teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës;

b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë;

c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuara nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional).

Në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohej se: "Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën "b" të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magjistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i

Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm."

Ndërsa në nenin 19/1 parashikohej se: "Vlerësimi i këshillit pedagogjik bëhet me 5 shkallë: a) shkëlqyeshëm; b) shumë mirë; c) mirë; ç) mjaftueshëm; d) pamjaftueshëm. Rregullat dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhur me vlerësimin e vitit të tretë, në nenin 20, paragrafi i parë i ligji, parashikohej se: "Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit."

Po ashtu, në Rregulloren e Brendshme të Shkollës, parashikohej se: "Në fund të stazhit profesional bëhet vlerësimi i akteve dhe vendimeve të përpiluara nga kandidatët gjatë vitit. [...] Vlerësimi përfundimtar i vitit të tretë bëhet nga Këshilli Pedagogjik."

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor të kohës, referuar më sipër, rezulton se periudha e stazhit profesional, e cila zhvillohej gjatë gjithë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, ka qenë pjesë integrale e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të detyrës, i është nënshkruar vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës. Për pasojë, kjo periudhë e veprimtarisë profesionale nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit, pavarësisht se gjyqtari {...} e ka pasur statusin e gjyqtarit edhe gjatë praktikës profesionale.

Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për një periudhë të caktuar vlerësimi, nuk mund të mbivendoset me vlerësimin që bën vetë Shkolla e Magjistraturës, për të njëjtën periudhë vlerësimi, për kandidatët e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, për shkak se edhe pse për të njëjtën periudhë, kandidati i vitit të tretë sipas ligjit të kohës, ka pasur statusin e gjyqtarit, i vetmi organ që ka pasur kompetencën e vlerësimit etik dhe profesional të tij ka qenë Shkolla e Magjistraturës, vlerësim mbi të cilin është bërë edhe pikëzimi dhe renditja e tij me rastin e diplomimit nga kjo Shkollë.

Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: "5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale,

të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës". Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas Ligjit "Për Statusin", vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur. Me termin "Ligj" do të kuptohet jo vetëm Ligji për Statusin, por edhe Ligjet e tjera që afektojnë për shkak kompetence të organit, gradimin e gjyqtarëve, sikundër është Ligji nr.8136, datë 31.7.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i cili për periudhën tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, përcaktonte si organ kompetent Shkollën e Magjistraturës, për të bërë vlerësim etik dhe profesional për gjyqtarët në vitin e tretë të programit të formimit fillestar.

Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës së z. {...}, në raport me periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2013-2016, rezulton se ai ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhën 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë. Edhe nëse vitin 2016 do ta konsiderojmë vit të plotë pune për efekt të periudhës së vlerësimit, kohëzgjatja e detyrës së gjyqtarit përkon me 6 muaj e 7 ditë.

Në nenin 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, parashikohet se: "1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmës magjistrat ose magjistrat i komanduar. 2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale".

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 "Rregulla plotësuese të

vlerësimit të gjyqtarëve", lidhur me periudhën e vlerësimit, parashikohet se: "4. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit".

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, për z. {...}, në kushtet kur rezultoi se koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013–2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi, në kuptim të neneve 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, procedura e vlerësimit etik dhe profesional të filluar për periudhën 3-vjeçare që përfshin vitet 2013-2016, nuk mund të vazhdojë. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal 1-vjeçar, është miratuar nga Këshilli, për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim.

Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtari pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, nuk rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë profesionale për një kohëzgjatje minimale prej një viti, brenda periudhës së vlerësimit 2013–2016, rezulton se objekti për të cilin ka filluar procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) është i pamundur të realizohet dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure vlerësimi nuk mund të vazhdojë.

Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur një parashikim për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar. Në zbatim të nenit 97 pika 3 të Ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli zbaton K.Pr.Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohet se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

Në rastin konkret, me konstatimin e mungesës së kushteve ligjore për të përcaktuar si periudhe të plotë vlerësimi, periudhën 3-vjeçare 2013–2016, për z. {...}, realizimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, sipas parashikimeve të nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, rezulton të jetë objektivisht i pamundur. Për pasojë, vijimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013–2016 për z. {...}, nuk mund të vazhdojë. Ndërkohë që për periudhën e vlerësimit 2017–2019 për këtë gjyqtar Këshilli ka filluar vlerësimin e tij

etik dhe profesional.

Projektvendimi është i strukturuar në katër pjesë:

Në pikën 1 të tij përcaktohet përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për shkak se objekti për të cilën kishte nisur kjo procedurë është i pamundur të realizohet, pasi koha e ushtrimit të detyrës nga gjyqtari, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për përfundimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar t'i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual të Këshillit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ftoj anëtarët nëse kanë ndonjë diskutim për çfarë u relatua?

Nëse nuk keni diskutime kalojmë në miratimin e projektvendimit për të cilin jeni bërë me dije.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2022)

***Pika 13 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për përjashtimin e gjyqtares {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:45 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ, Këshilltarë (Komisionet e Përhershme).

5. BIRN.

6. Kateriana Çela, Greta.

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përjashtimin e gjyqtares {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 13 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit Zëvendëskryetar!

Ne kemi përgatitur relacionin për projektvendimin "Për përjashtimin e gjyqtares {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është protokolluar shkresa me nr. {...} prot., datë 28.09.2022, e paraqitur në formë elektronike nga znj. {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet (njëkohësisht zëvendëskryetare e kësaj gjykate), me lëndë: "Kërkesë për përjashtimin nga delegimet". Nëpërmjet kësaj kërkese gjyqtarja

kërkon të përjashtohet nga delegimi (caktimi në gjykata të tjera për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta), për arsye shëndetësore të saj dhe për shkak të përfitimit së shpejti nga leja e lindjes. Gjyqtarja shprehet se për shkak të problemeve gjatë shtatzënisë, nga ana e mjekut specialist i është rekomanduar të evitojë udhëtimet dhe të qëndrojë në regjim shtrati.

Gjyqtarja i ka bashkëlidhur kërkesës: Eko Obstetrikale, datë 03.09.2022, Eko Morfologjike datë 28.07.2022, ekzaminim obstetrikal datë 21.05.2022, raport për paaftësi të përkohshme në punë (nga data 13.09.2022 deri më datë 16.09.2022).

Të njëjtën kërkesë, gjyqtarja {...} e ka paraqitur edhe në rrugë postare, protokolluar pranë KLGJ-së më datë 30.09.2022.

Vlen të mbahet parasysh se gjyqtarja {...} edhe më parë, i ka kërkuar ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë përjashtimin e saj nga procesi i delegimeve për shkaqe shëndetësore. Në këtë rast, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 54, datë 19.11.2018, ka vendosur të pranojë si të bazuar kërkesën e gjyqtares dhe ta përjashtojë atë deri në 6 muaj nga lista e gjyqtarëve që delegohen, për shkaqe shëndetësore dhe familjare të saj.

Po ashtu, e njëjta kërkesë është përsëritur nga gjyqtarja {...} edhe përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili, me vendimin nr. 73, datë 20.05.2019, ka vendosur përjashtimin e gjyqtares në fjalë nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6 (gjashtë) mujor. Ndërkohë, përmes vendimit nr. 231, datë 02.07.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur mospranimin e kërkesës së gjyqtares {...} për përjashtimin e saj nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Rregullat për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019 “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i ndryshuar. Në këto rregulla, në paragrafin VIII, ku flitet për përjashtimin e gjyqtarit nga ky proces, në pikën 6 të tij, parashikohet se: “Me

kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për arsye shëndetësore, mund të vendosë përjashtimin gjer në gjashtë muaj të një gjyqtari nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta".

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë se gjyqtarja {...} ka paraqitur kërkesë të motivuar dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme që vërtetojnë gjendjen e saj shëndetësore dhe të shtatzënisë së saj, konform pikës 6, paragrafit VIII, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon përjashtimin për një afat 6 (gjashtë) muaj të gjyqtares nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ftoj anëtarët nëse kanë ndonjë?

Kalojmë tek miratimi i projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. *(Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar. Sipas e-mailit zoti Toro ka qenë me vullnetin e KZHK-së.)*

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për përjashtimin e gjyqtares {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku

ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Këshilli i lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përjashtimin e gjyqtares znj.{...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6 (gjashtë) mujor.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, janë të ezauruara të gjitha çështjet. Atëherë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor